



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.32/2018

Prishtinë, më 8 tetor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci, Shemsi Sylja dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Luljeta Veselaj-Gutaj, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Hilmi Jashari-IAP, Merita Sylja dhe Edona Hajrullahu-IAP, Adelina Hasani-KDI, Leutrim Morina-KDI, Flora Kryeziu-UNICEF, Fitore Ademi-RTV21, Drita Vitia-Radio Kosova, Liridona Ademaj-Kallxo.com dhe Teuta Prekazi-UN HUMAN RIGHTS.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (I ftuar Avokati i Popullit z.Hilmi Jashari)
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (I ftuar Avokati i Popullit z.Hilmi Jashari)

Kryetarja, tha se kemi në shqyrtim raportin me rekomandime për monitorimin të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, me këtë më për së afërmi është marr grupi punues që ka qenë i autorizuar të bëjë mbikëqyrjen. Në mungesë të kryesueses së grupit punues, e cila mungoi me arsye, fjala iu dha anëtares së grupit punues, Mirjeta Kalludra.

Mirjeta Kalludra, tha se grupi punues pas monitorimit të zbatimit të ligjit në terren, i ka hartuar tri rekomandime, për të cilat kërkojmë mbështetje nga komisioni, por edhe nga IAP-i. Ajo pas një elaborimi të raportit, u ndal në rekomandimet e propozuara si në vijim:

- I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës të hartojë Projektligjin e ri për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- I rekomandohet Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, që gjatë amendamentimit të Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës, çështjen e diskriminimit ta trajtojë si vepër penale;
- Qeveria e Republikës së Kosovës në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, të parasheh koston financiare për rekrutimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi nga ana e komunave dhe në 5 (pesë) Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo pozitë është e pambuluar, në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Kalludra tha, se si Komision, këto rekomandime i kanë shqyrtuar edhe në mbledhjen e kaluar të komisionit dhe tash kërkojmë ta dëgjojmë mendimin e Avokatit të Popullit, në lidhje me rekomandimet.

Hilmi Jashari, Avokat i Popullit, tha se Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka paraparë pesë procedura: atë civile, administrative, kundërvajtëse, penale edhe procedurën para Avokatit të Popullit dhe nuk ka një qartësim juridik se cila procedurë mund të fillojë dhe cila të pushojë.

Kjo nënkupton një situatë të pafavorshme për qytetarët sepse në mënyrë hipotetike mund të ndodhë, t'i kemi pesë vendime që dallojnë njëra prej tjetrës, për të njëjtën çështje dhe bie ndesh me parimin e drejtësisë që nuk mund të gjykoresh dy herë për të njëjtën çështje. Në anën tjetër, sistemi i ynë i drejtësisë nuk pranon që në të njëjtën kohë të paraqitesh si palë në procedurë civile dhe në procedurë penale.

Janë saktësisht procedurat të cilat e kanë pamundësuar që të jetësohet ky ligj. Më e lehtë është të bëhet ndryshimi i ligjit sepse vetëm te procedurat kemi një problem, i cili do të duhej të harmonizohej, dhe për mendimin tim pastaj duhet Kuvendi të vendos, se në cilën procedurë po e udhëzojmë qytetarin.

Teuta Haxhiu, tha se Kodi Penal është në procedurë dhe deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, do ta përfaqësojë qëndrimin e komisionit tonë në Komisionin për Legjislacion dhe atje të kërkojmë që kjo të jetë si vepër penale. Nëse Komisioni Funkcional kërkon nga Qeveria ndryshimin e plotësimin e ligjit, atëherë kjo mund të jetë një procedurë më e gjatë.

Hilmi Jashari, tha se është dakord të kalojë procedura nga Kuvendi, sepse është rrugë më e shpejt. Nëse ka nevojë për një ekspertizë, ka hapësirë shumë të madhe, nëse jo, prej institucioneve tona vendore. Komisioni i Venedikut shpresoj se është i gatshëm, dhe ne veç jemi pjesë e këtij sistemi dhe mund të kërkojmë ekspertizë. Mendoj se nuk ka shumë punë dhe e vetmja problematikë, mendoj se është te pjesa procedurale, por gjithnjë që të jetë mjet juridik që prodhon efekt dhe që funksionon në praktikë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është mirë të punohet për plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji. Dimë se ekzistojnë njësitet për të drejtat e njeriut nëpër institucione dhe këta mekanizma mungojnë diku nëpër këto institucione dhe për këtë është propozuar rekomandimi i tretë.

Ajo u interesua të dijë nga IAP-i, si institucion, a kanë pasur ankesa nga qytetarët apo ndonjë raport nga institucionet tjera, apo KMDLNJ-ja, për rastet e diskriminimit.

Më pas, ajo komentoj rreth nenit 9 pika 2.14, ku thuhet se IAP-i mund të hartojë kode të praktikave të mira për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë, që mund të përdoren si pikë referimi në rastet e diskriminimit.

Hilmi Jashari, tha se kemi hartuar një kod të praktikave të mira, i cili ka pasur për qëllim lehtësimin për institucionet e tjera praktikues të ligjit se si duhet të zbatohen këto standarde që kanë të bëjnë me ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.

Kryetarja, konstatoi se në lidhje me raportin për monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, në rekomandimin e parë, të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i ligjit dhe nisma të bëhet nga Komisioni Funkcional.

Në lidhje me rekomandimin e tretë, ajo tha se është në rregull, kurse në lidhje me rekomandimin e dytë, Komisioni Funkcional do të vendosë në mbledhjen e ardhshme për këtë çështje.

Lirije Kajtazi, pyeti nëse behet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, a është mirë të parashohim pozitën e komisionarit për mbrojtje nga diskriminimi?

Hilmi Jashari, tha se modeli më i mirë i funksionimit ka qenë Suedia, ku Institucioni i Avokatit të Popullit ka një rol të rëndësishëm. Për Kosovën krijimi i mekanizmave të ri shkakton kosto shtesë buxhetore. Ndërsa komisionari kompetencë shtesë ka përfaqësimin në gjykata të pjesëtarëve të sektorit privat.

Shemsi Sylja, pyeti rreth publikimit të listave të veteranëve të ashtuquajtur mashtrues dhe tha se shumë e kanë cilësuar si shkelje të privatësisë dhe shkelje shumë e rëndë që u është bërë veteranëve të UÇK-së. Çfarë keni bërë si Institucion i Avokatit të Popullit për këtë çështje?

Hilmi Jashari, tha se kemi bërë një raport me opinion që nuk është i obligueshëm por jep një këshillë, gjithnjë në bazën e interesit të përgjithshëm, ndërsa raporti është publik. Sa i përket kësaj çështje, mendoj se ka shkelje të privatësisë. Deri më tash kemi pranuar 4 ankesa me këtë pretendim. Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, për këtë është kompetent të jep vlerësim Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për këtë nuk kemi hy në këtë vlerësim.

2. Të ndryshme.

Kryetarja, tha se kemi diskutuar disa herë për çështjen e personave të zhdukur në aktivitete të ndryshme dhe kemi diskutuar që këtë çështje ta prezantojë Saranda Bogujevci, në emër të komisionit. Anëtarët e Komisionit ishin të mendimit që kjo temë të diskutohet në një mbledhje tjetër të Komisionit.

Kryetarja, njoftoi se më 6 tetor do të jenë në vizitë në Prizren dhe në Deçan. Po ashtu, ajo njoftoi edhe lidhur me shqyrtimin e dy peticioneve nga ana e grupit punues, lidhur me një kërkesë të një nëne për shkollimin e fëmijës në burg, por kemi marrë informatën po nga nëna se Ministria e Drejtësisë ka marrë vendim që shkollimi për këtë person të fillojë në shtatorin e vitit 2019.

Ndërsa për kërkesën e Murat Mustafiqit, do ti drejtohem me një shkresë si Komision Funkcional, organeve gjyqësore, që të përshpejtojë procedurën e shqyrtimit të kësaj lënde, pasi që lënda është në gjykatë.

Lirije Kajtazi, tha se çka i ka ndodhur kësaj vajze,. Në lidhje me përshkrimin në peticion, tha se do ta përkrah deri sa të vihet drejtësia në vend.

Kajtazi, po ashtu, tha, se në veriun e Mitrovicës, nxënësit ende po mësojnë në kontejner për shkak se nuk po lejohet të ndahet një parcelë për ndërtimin e shkollës, dhe është mirë të dëgjohet MASHT-i, të shohim se çka ka ndërmarrë por edhe autoritetet lokale përgjegjëse pse nuk e ndajnë atë pronë kur ka mundësi.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në e-mail e kem i një kërkesë për organizimin e një tryeze nga Organizata Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

Kryetarja, tha se pati një takim me përfaqësuesit e kësaj organizate dhe është një kërkesë kur ata të përfundojnë me monitorimin në mënyrën e vet, atëherë Komisioni të organizojë një tryezë me aktorët përgjegjës, në lidhje me zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013 – 2023.

Mexhide Mjaku-Topalli, theksoi se derisa MPMS-ja, është duke hartuar një draft koncept për Projektligjin për personat me aftësi të kufizuar, pra ligjin gjithëpërfshirës, është mirë që javën e ardhshme të ftojme një përfaqësuese nga organizata, MPMS, MASHT, dhe MSH, para se të organizojmë një tryezë dhe të shohim sa është zbatuar strategjia.

Kryetarja, konstatoi se javën e ardhshme, të hënën të ftohen ministrat e tri ministrive të lartpërmendura, në Komisionin Funkcional të raportojnë në lidhje me zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023, ndërsa të ftohet në këtë takim edhe Organizata Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar.

Florije Kryeziu, tha se takimin e fundit është e përmendur një vizitë tek familjet strehuese dhe këtë mund ta organizojmë, ku sipas propozimit të drejtorit të Zyrës së UNICEF-it, ti bashkohen edhe anëtarët e Komisionit. Nëse pajtoheni, kemi propozuar komunën e Gjakovës sepse ka një përvojë me familjet strehuese. Këtë mund ta bëjmë edhe me drejtorin e QPS-së në komunë, me kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Departamentit për Shëndetësi.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është mirë të dijë, cilat komuna kanë më shumë familje strehuese dhe pastaj t'i vizitojmë, dhe është mirë që gjatë vizitave të përfshihen dy komuna brenda ditës.

Florije Kryeziu, propozoi qër më 20 nëntor, ditën kur është miratuar Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, të bëjmë një dëgjim publik dhe të ftojme ministritë që obligohen të zbatojnë rekomandimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe të ftohen fëmijët si palë e tretë, ku ata kanë kërkuar llogari prej institucioneve.

Saranda Bogujevci, tha se është mirë si anëtarë të Komisionit, t'i takojmë fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, dhe disa familje. Së bashku me medie, të bëjmë një fushatë për vetëdijesimin e opinionit në lidhje me trajtimin e këtyre fëmijëve nëpër shkolla.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje